




REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE

Qendra e Thirrjeve për Tatimpaguesit, shërbim i ri në ndihmë të sipërmarrjes. Komunikim intensiv për nxitjen e vetëkorrigjimit

2017-03-20 16:17:00



Ministri i Financave Arben Ahmetaj dhe Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve Vasilika Vjero, zhvilluan sot një vizitë në zyrat e shërbimit të tatimpaguesve për promovimin e Qendrës së Thirrjeve (Call Center) për Tatimpaguesit, shërbimi më i ri në ndihmë të sipërmarrjes.

Qendra e thirrjeve për tatimpaguesit nga data 1 shkurt ka filluar të operojë me kapacitet të plotë përmes tre formave të komunikimit me sipërmarrjen, thirrjet dalëse, thirrjet hyrëse dhe live chat, (përmes dritares së komunikimit që aksesohet drejtpëdrejt nga faqja zyrtare e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve).

Ministri Ahmetaj u shpreh se ky shërbim i ri për tatimpaguesit është një tjetër nismë në vazhdim të punës së nisur me thjeshtimin e procedurave tatimore në kuadër të fazës së dytë e të tretë të luftës kundër informalitetit, e fokusuar tashmë tek komunikimi i përditshëm, intensiv, me sipërmarrjen me qëllim nxitjen e pajtueshmërisë me ligjin dhe vetëkorrigjimin.

“Call Center për tatimpaguesit, është një shërbim në funksion të lehtësimit të procedurave tatimore. Është një risi në shërbimin që ofron Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe funksionon në dy mënyra kryesore. Pikë së pari këtu operatorët dhe specialistët, informojnë sipërmarrjen për të gjitha problematikat që mund të dalin gjatë punës së përditshme, pra, lehtëson procedurën nëpërmjet punës nga zyra dhe komunikimit nga zyra me sipërmarrjen. Në të njëjtën kohë, sipërmarrja ka mundësinë të pyesë specialistët e shërbimit të tatimpaguesve online, për të marrë përgjigjet e duhura në kohë reale, apo për t’u orientuar në Drejtoritë Rajonale për çështje specifike që kanë nevojë për këshillim apo për orientim. Frytet e para të punës duken qartë, vetëm në shkurt janë njoftuar nga kjo qendër 25 mijë tatimpagues të biznesit të vogël dhe reagimi ka qenë jashtëzakonisht shumë pozitiv. Besoj që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve po bën një punë shumë të mirë për të përmirësuar cdo ditë imazhin e punës së vet, por edhe duke përmirësuar cdo ditë komunikimin me tatimpaguesit. Ne besojmë që nëpërmjet komunikimit të rrisin vullnetarizmin në pagesa dhe qatësimin e të gjithë procedurave” – tha Ministri Ahmetaj. Ndërsa Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve Vasilika Vjero u shpreh se ky është një shërbim i ri, i pari i këtij lloji që u ofrohet tatim paguesve.

“Unë do të doja të nxisja të gjithë tatimpaguesit për të përdorur shërbimet tona online, sepse sigurisht që janë shërbime profesionale, por nga ana tjetër shkurtojnë kohe dhe kosto për të mos u paraqitur pranë sporteleve tona, por për t’i vijuar ato nëpërmjet shërbimeve të përmirësuar online. Gjithashtu i ftoj qytetarët, bizneset, tatimpaguesit të na ndihmojnë me sugjerimet e tyre për t’u përmirësuar, sepse sigurisht mendimi i tyre është shumë i vlefshëm për ne, na ndihmon në përmirësimin e punës sonë të përditshme” – tha Vjero.

Qendra e Thirrjeve për Tatimpaguesit. Mbi 50 sipërmarrje në ditë kërkojnë asistencë nga qendra e thirrjeve përmes thirrjeve hyrëse. Nga 1 Janari deri më 15 Mars 2017 janë realizuar rreth 30 mijë telefonata me tatimpagues, për njoftime të natyrave të ndryshme: tatimpagues të biznesit të vogël për deklarimin e saktë të ardhurave të tyre brenda afatit 10.02.2017; tatimpagues të sektorit shëndetësor për të vetëkorrigjuar deklaratimet e tyre, tatimpagues si mosdeklarues të xhiros me kasën fiskale etj. Aktualisht qendra është në përgatitje të fushatës së komunikimit për procesin e dorëzimit të Pasqyrave financiare, Bilanceve, afati për të cilat përfundon më 31 Mars 2017. Po kështu në muajin në vijim vec të tjerash fushata do të përqëndrohet në njoftimin e Individëve të cilët realizojnë të ardhura vjetore mbi 2 milionë lekë.

Qendra e Thirrjeve për tatimpaguesit është operative nga e Hëna në të Enjte nga ora 09:00 - 20:00 dhe ditën e premte nga ora 09:00 deri 16:00. Tatimpaguesit mund të telefonojnë në numrin e gjelbër pa pagesë: 0800 00 02.